



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 02/1034 Dt. 23 / 09 /2015

**RREGULLORE
MBI PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES TË
UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" GJILAN**

Gjilan, 2015

Në bazë të nenit 20, pika 1, të Statutit të Përkoħshem Universitetit “Kadri Zeka”, Këshilli Drejtues i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.08.2015, miratoi:

RREGULLOREN
mbi punën e Këshillit Drejtues të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Këshillit Drejtues të Universitetit të “Kadri Zeka” Gjilan (thirrja e mbledhjes, mbajtja, mënyra e vendosjes dhe zbatimi i vendimeve, si dhe çështjet e tjera përkatëse).

II. VERIFIKIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 2

Mbledhjen konstitutive të Këshillit Drejtues e thirret anëtar i më i vjetër nga përbërja e zgjedhur, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjidhet kryesuesi i Këshillit Drejtues.

Neni 3

- 1) Në mbledhjen e parë, Këshilli Drejtues e verifikon mandatin e anëtarëve të Këshillit Drejtues në bazë të raportit të sekretarit të përgjithshëm, në lidhje me rregullsinë e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues nga Senati, si dhe të emërtimit të zgjedhjes së anëtarëve në Këshillin Drejtues nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me propozim për verifikimin e mandatit.
- 2) Raporti votohet në dy pjesë, njëherë për anëtarët e zgjedhur nga Senati dhe njëherë për anëtarët e emëruar nga MASHT-i.
- 3) Nëse Këshilli Drejtues konstaton se emërimet nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ose nëse ekziston ndonjë konflikt interes i për një apo më shumë anëtarë të Këshillit Drejtues, atëherë kërkon nga institucioni përkatës zgjedhjet apo emërimet e kontestuara brenda një periudhe prej dy javësh.
- 4) Në rast të kontestimit të zgjedhjeve apo emërimeve, mbledhja konstitutive e Këshillit Drejtues ndërpritet derisa zgjedhjet apo emërimet të jenë përsëritur në mënyrë të suksesshme.

Neni 4

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e pranishëm të Këshillit Drejtues e nënshkruajnë deklaratën me sa vijon: “Deklaroj se do t’i kryej detyrat me nder dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, se do të kontribuoj në përbushjen e detyrave të Këshillit Drejtues, se do ta ushtroj mandatin tim me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t’i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e Universitetit dhe se do t’i përbahem Statutit të Universitetit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

III. ZGJEDHJA E KRYESUESIT TË KËSHILLIT DREJTUES

Neni 5

- 1) Kryesuesi i Këshillit Drejtues zgjidhet me shumicën e votave nga radhët e anëtarëve të deleguar nga MASHT-i.
- 2) Zëvendëskryesuesi zgjidhet me shumicën e votave nga radhët e anëtarëve të emëruar nga MASHT-i.

IV. MBLEDHJET

Neni 6

- 1) Mbledhjet e Këshillit Drejtues i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Këshillit Drejtues.
- 2) Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson zëvendëskryesuesi. Nëse edhe kryesuesi edhe zëvendëskryesuesi nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Këshillit Drejtues e kryeson anëtarët më i vjetër i Këshillit Drejtues.
- 3) Kryesuesi i thërret mbledhjet sipas nevojës.
- 4) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këto mbledhje duhet të jetë i kufizuar me një pikë kryesore. Gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhjeje të ardhshme të Këshillit. Në këto raste, anëtarët e Këshillit Drejtues që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.
- 5) Në rast të shkarkimit të kryesuesit dhe të zëvendëskryesuesit, anëtarët më i vjetër i Këshillit Drejtues e organizon procedurën e zgjedhjes pa asnjë vonesë.
- 6) Mbledhjet e Këshillit Drejtues janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli Drejtues vendos ndryshe. Ato duhet të përcillen përmes mjeteve audiovizuele.
- 7) Anëtarët e Këshillit Drejtues do të ftohen më së paku tri ditë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, me e-mail ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurtë.
- 8) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe që të ftojë në mbledhje ekspertë ose persona të tjera.
- 9) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Këshillit Drejtues nëse këtë e kërkojnë së paku 2/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe nëse qëllimi është i arsyetur me shkrim.
- 10) Nëse kryesuesi/zëvendëskryesuesi i Këshillit Drejtues nuk i përgjigjet kërkesës e së paku 2/3 të anëtarëve të Këshillit Drejtues për thirrjen e mbledhjes brenda afatit prej tri ditësh, mbledhjen e thërret anëtarët më i vjetër i Këshillit Drejtues.

V. PJESËMARRJA NË MBLEDHJE DHE PËRFAQËSIMI

Neni 7

- 1) Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues.
- 2) Anëtarët e Këshillit Drejtues votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
- 3) Para se të fillojë mbledhja e Këshillit Drejtues, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtarët i Këshillit Drejtues mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtarët i Këshillit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
- 4) Rektori dhe sekretari i përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote.
- 5) Me ftesë të Këshillit Drejtues, në takimet e Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë edhe prorektorët, por pa të drejtë vote.
- 6) Kryesuesi i Parlamentit të Studentëve mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me studentët. Pjesëmarrja koordinohet paraprakisht me kryesuesin e Këshillit Drejtues.

Neni 8

- 1) Për një anëtar të Këshillit Drejtues konsiderohet se ka konflikt interesë, në pajtim me rregulloret përkatëse të Ligjit për shërbime publike të Kosovës dhe Statutit të Universitetit, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.
- 2) Nëse Këshilli nuk vendos ndryshe, anëtarë në konflikt interesë duhet ta lëshojet mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.

VI. FILLIMI I MBLEDHJES DHE MIRATIMI I RENDIT TË DITËS

Neni 9

- 1) Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
- 2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit Drejtues kujdeset kryesuesi në bashkëpunim me zëvendëskryesuesin, të cilit i ndihmojnë sekretari i përgjithshëm dhe rektori.
- 3) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, e propozon rendin e ditës, e hap diskutimin rreth rendit të ditës, e konstaton miratimin e rendit të ditës.
- 4) Kryesuesi ia jep fjalën diskutuesit, e konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, e konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, e konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime të tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes sipas kësaj rregulloreje.
- 5) Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
- 6) Materialet ose kérkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes, mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote.

VII. ECURIA E MBLEDHJES

Neni 10

- 1) Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- 2) Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.
- 3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet, propozimet lidhur me çështjet, të cilat do të vendosen në mbledhje.
- 4) Kryesuesi e jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e Këshillit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- 5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së punës, për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas rendit.
- 6) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përbahen temës.
- 7) Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen përkohësisht, më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Këshillit Drejtues, kjo pikë mund të vazhdohet.
- 8) Kryesuesi ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen, nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e mbledhjes.

Neni 11

Këshilli Drejtues, në bazë të propozimit të kryesuesit apo të ndonjë anëtar të Këshillit Drejtues, mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

VIII. PARASHTRIMI I KËRKESAVE-ANKESAVE

Neni 12

- 1) Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtë të parashtrojë kërkësë-ankesë për temën e caktuar.
- 2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkësa-ankesa të parashtrohet me shkrim.

IX. VENDOSJA-VOTIMI DHE ZGJEDHJET

Neni 13

- 1) Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet kuorumi prej katër anëtarëve. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të plotfuqishme vetëm nëse kuorumi vërtetohet në kohën e votimit.
- 2) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- 3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Këshilli Drejtues merr vendim ose konkluzion sipas pikës së rendit të ditës.
- 4) Këshilli Drejtues i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare.
- 5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose për propozimet nga organet e Universitetit, e pastaj për propozimet e tjera.
- 6) Votimi bëhet i hapur, me ngritje dore ose me vota të fshehta. Për mënyrën e votimit Këshilli Drejtues vendos në mbledhjen përkatëse, nëse me Statutin e Universitetit nuk është paraparë ndryshe.
- 7) Votimi bëhet: “për”, “kundër” dhe “abstinen”.

Neni 14

- 1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i formuar nga Këshilli, në përbërje prej tre anëtarëve. Së paku një anëtar i këtij komisioni duhet të jetë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Senati apo nga radhët e anëtarëve të emëruar nga MASHT-i.
- 2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.

Neni 15

- 1) Për vendimet e mëposhtme të Këshillit Drejtues nevojitet shumica e kualifikuar e 2/3 të votave të anëtarëve:
 - a) Për shkarkimin e rektorit dhe të prorektorëve;
 - b) Për planin vjetor financier;
 - c) Për miratimin e rregullores së punës.
- 2) Votimi me vota të fshehta bëhet për:
 - a) Zgjedhjen dhe shkarkimin e rektorit;
 - b) Zgjedhjen dhe shkarkimin e prorektorëve;
 - c) Inicimin për shkarkimin e dekanëve dhe të prodekanëve;
 - d) Çështjet që kanë ndikim në çështjet private të ndonjërit prej anëtarëve të Këshillit Drejtues;
 - e) Çështjet ku kryesuesi apo shumica e anëtarëve të pranishëm kërkojnë votim të fshehtë.
- 3) Numërimi i votave për këto çështje bëhet në praninë e anëtarëve.

X. ZGJEDHJA E REKTORIT

Neni 16

- 1) Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues nga lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni profesional prej tre apo pesë anëtarësh, të cilin e formon Senati. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
- 2) Rektori zgjidhet me votim të fshehtë nëpërmjet fletëvotimeve. Fletëvotimi do t'i përmbarë të gjithë kandidatët e përcaktuar në listën e komisionit profesional. Secili anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtë ta rrumbullakojë një kandidat në fletëvotim.

Fletëvotimet që kanë të rrumbullakuar më shumë se një kandidat do të konsiderohen të pavlefshme. Numri total i votave numërohet për secilin kandidat. Kandidati, i cili e arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote, zgjidhet rektor.

- 3) Nëse asnjë kandidat nuk e arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e parë, dy kandidatët me numër më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë.
- 4) Nëse asnjëri prej dy kandidatëve nuk arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në tri radhë të njëpasnjëshme të votimit, procedura e zgjedhjes do të përsëritet nga fillimi, d.m.th. me shpalljen e konkursit për pozitën e rektorit.
- 5) Këshilli Drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga komisioni profesional.

XI. ZGJEDHJA E PROREKTORËVE

Neni 17

- 1) Rektori e propozon listën e emrave për prorektoresh nga radhët e profesorëve Universitar, pasi të jetë konsultuar me Senatin. Propozimi me shkrim duhet t'u dorëzohet anëtarëve të Këshillit Drejtues më së voni kur dërgohet ftesa për mbledhjen për zgjedhje.
- 2) Propozimet duhet të janë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe jetëshkrimin e kandidatit.
- 3) Prorektoresh zgjidhen nga Këshilli Drejtues me shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- 4) Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet, atëherë rektori ka të drejtë ta propozojë kandidatin e ri, sipas procedurës së paraparë.

XII. MBAJTJA E RENDIT NË MBLEDHJE

Neni 18

- 1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi.
- 2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Këshillit Drejtues janë të obliguar që t'i përbahen kësaj rregulloreje.
- 3) Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - a) Vërejtje,
 - b) Marrja e fjalës, dhe
 - c) Largim nga mbledhja.

Neni 19

- 1) Vërejtje me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit, nëse me sjelljen dhe diskutimin e tij e çrrëgullon dhe e pengon punën normale të mbledhjes.
- 2) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Këshillit Drejtues, i cili me sjelljet dhe deklaratat e tij e çrrëgullon punën normale të Këshillit Drejtues, për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
- 3) Vërejtjen dhe marrjen e fjalës ia shqipton kryesuesi.
- 4) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit, nëse edhe pas marrjes së fjalës e pengon mbarëvajtjen e mbledhjes.
- 5) Largimin nga mbledhja e shqipton Këshilli Drejtues me shumicë votash. Pjesëmarrësi, të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë ta lëshojë mbledhjen. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

XIII. PROCEVERBALI NGA MBLEDHJA E KËSHILLIT DREJTUES

Neni 20

- 1) Në çdo mbledhje të Këshillit Drejtues mbahet procesverbal. Procesverbal i nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga procesmbajtësi.
 - 2) Prosesverbali duhet t'i përmbajë këto elemente:
 - a) Vandin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes;
 - b) Rendin e ditës;
 - c) Listën e pjesëmarrësve dhe të atyre që mungojnë;
 - d) Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, dhe
 - e) Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.
- Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalarit si aneks.
- 3) Prosesverbali duhet të përgatitet brenda një javë pas mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe si ekstrat duhet t'u dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të Këshillit Drejtues.
 - 4) Prosesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Drejtues.
 - 5) Prosesverbali ruhet në arkiv të Universitetit me materialet shqyrtuese, sipas pikëve të rendit të ditës, si dokumente afatgjate.

XIV. PUNA E KOMISIONEVE

Neni 21

- 1) Komisionet janë organe ndihmëse të Këshillit Drejtues.
- 2) Komisionet formohen nga Këshilli Drejtues në pajtim me Statutin e Universitetit dhe e ndihmojnë Këshillin Drejtues lidhur me çështjet e veçanta të punës së tij.

XV. AKTET E KËSHILLIT DREJTUES

Neni 22

- 1) Këshilli Drejtues nxjerr:
 - Rregullore,
 - Vendime,
 - Konkluzione,
 - Rekomandime.
- 2) Këshilli Drejtues jep interpretim autentik të akteve që miraton.
- 3) Prosesmbajtësi është i obliguar që t'i përgatisë vendimet dhe rekomandimet nga mbledhja e Këshillit Drejtues, ndërsa rregulloret i përgatit komisioni përkatës.

Neni 23

Dispozitat e kësaj rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe personave të tretë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Këshillit Drejtues.

Neni 24

Për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë.

XVI. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 25

- 1) Për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje kujdeset kryesuesi i Këshillit Drejtues.
- 2) Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e jep Këshilli Drejtues.
- 3) Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.

Neni 26

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Akademik Fejzullah Krasniqi

